



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02/ Nr. 5330  
Data: 18. 06. 2024

PROCESVERBAL I DEBATIT PUBLIK  
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUHETORE  
(KAB) 2025-2027 – PALDENICË

Procesverbali nga Debat i parë publik në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025 - 2027 u zhvillua me datën **13.06.2024** duke filluar nga ora 13:30 në SHFMU "Kështjella e Diturisë" në Paldenicë, në të cilin ishin gjithsej 11 pjesëmarrës, prej të cilëve 3 ishin gra dhe 8 burra.

Debatin publik nga Zyra e Kryetarit të Komunës e kryesoi Drejtora për Buxhet dhe Financa – Lindita Ballazhi e cila i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre, ndërkaq morën pjesë edhe drejtore e drejtore nga ekzekutivi i Komunës, ku për rend të ditës kishin:

1. Prezentimi i Kornizës Aftmesme Buxhetore 2025-2027
2. Diskutimi i hapur

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 e prezentoit Drejtora për Buxhet dhe Financa, **znj. Lindita Ballazhi**.

1. Prezentimi i Draft Kornizës Aftmesme Buxhetore

**Lindita Ballazhi:** Jemi në fazat e hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 ose thënë më ndryshe planifikimet fillestare buxhetore. I gjithë ky proces mbështetet në Ligjin për Financa Publike dhe Përgjegjësitë, ku gjithçka fillon nga muaji maj kur Qeveria e harton kornizën afatmesme të shpenzimeve qeveritare në nivel të Kosovës dhe me anë të kësaj dërgohet Qarkorja e parë buxhetore nëpër komuna, në të cilën janë të specifikume shumat e ndara për çdo burim të financimit, pra me anë të së cilës hartohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027. Në KAB përvèç që kemi një analizë të hollësishme për shpënzimet që do të vijojnë vitin e ardhshëm, aty janë të specifikume edhe objektivat prioritare të qeverisjes, planet e punës, si dhe gjithçka është e bazuar në dokumentet strategjike të cilat i ka komuna. Fazat e buxhetit, fillimisht hartohet nga niveli qendror KASH-i apo Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, përcjellet Qarkorja e parë buxhetore, hartohet Korniza Afatmesme Buxhetore me anë të grupit punues për hartimin e KAB-it, e cila përcjellet për KPF dhe Kuvend Komunal, mbahen dëgjimet buxhetore, si dhe afati i fundit i kësaj faqe është miratimi i KAB-it me kufijtë fillestare në Kuvend Komunal deri me 30 qershor. Vijn faza tjetër ku niveli qendror e përcjell

Qarkoren e dytë buxhetore me kufijtë final buxhetor deri me 15 gusht, tani përsëri mbahen dëgjime buxhetore me qytetarë të lokaliteteve të ndryshme, si dhe deri me 1 shtator dorëzohet buxheti për vitin 2025 në Kuvend Komunal, dhe afati i fundit për ta aprovuar buxhetin eshtë 30 shtator nga Kuvendi Komunal, e pastaj vijon faza tjeter dorëzimi i këtij buxheti të cilin e ka miratuar Kuvendi Komunal në Departamentin e Buxhetit, gjegjësisht në Ministrinë e Financave, Punëve dhe Transfereve. Burimet e financimit të buxhetit komunal janë: Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik i Arsimit, Granti Specifik i Shëndetësisë, si dhe projeksiioni i Të Hyrave Vetanake komunale. Në grafikë e kemi të paraqitur buxhetin total për vitin 2025, pra Granti i Përgjithshëm për vitin 2025 eshtë me një pjesëmarrje prej 1,701,892.00 € apo 47.06%, vijon Granti Specifik i Arsimit me pjesëmarrje prej 1,167,634.00 € apo 32.29%, Granti Specifik i Shëndetësisë me pjesëmarrje 406,212.00 € apo 11.23%, si dhe projeksiioni i të Hyrat Vetanake Komunale me pjesëmarrje prej 339,719.00 € apo 9.39%, pra totali (Grantet + THVK) me pjesëmarrje prej 3,615,457.00 € apo 100.00 %. Këtë buxhet e kemi të ndarë në disa kategori buxhetore, ku për paga dhe shtesa në bazë të kalkulimeve tona do të shpenzojmë në vlerë prej 2,172,712.00 €, Mallra dhe Shërbime 584,500.00 €, Shpenzime Komunale 94,000.00 €, Subvencione dhe Transfere 143,000.00 €, si dhe Shpenzime Kapitale 621,245.00 €. Në vijim i kemi të planifikuara disa projekte kapitale, mirëpo ne jemi të hapur me i dëgju edhe kërkesat, sugjerimet apo rekomandimet e juaja, ku ne me këto propozime apo rekoamndime tuajt, do ta përgatisim listën për çdo qytetarë se çka ka propozuar dhe ajo listë do të dorëzohet në Kuvend Komunal, dhe fjala e fundit do të jetë e asamblesë komunale, të cilët do të propozojnë projekte të tjera apo do t'i miratojnë këto që ne i kemi përgatitur në këtë listë të projekteve, apo nga lista e projekteve të propozuara nga qytetarët përmes dëgjimeve buxhetore dhe formave të tjera të parashkimit të kërkesave apo propozimeve. Unë nuk do të kisha vazhdu më shumë, para jush e keni draft hartimin e KAB-it bashkë me projektet, ne jemi të hapur të diskutojmë për çdo projekt tek lista apo edhe të propozoni të tjera.

## 2. Diskutimi i hapur

**Zaim Bela – banor i fshatit Paldenicë dhe Këshilltar në Kuvendin Komunal:** Po e filloj unë, fillimisht me një kritikë për administratorin e fshatit që ai vet nuk qenka prezent sot në debat, por e kuptoj që janë edhe me punë të tjera. E dyta mendoj se eshtë pak herët mbajtja e debatit, ne gjithmonë i kemi mbajtë pas orarit të punës. Unë si banor i fshatit Paldenicë dhe si anëtarë i Kuvendit, siç e dini unë nuk kam votu në vitin paraprak për buxhetin e këtij viti, dhe kam qenë prezent që kemi pas kërkesa, edhe pse e di që buxheti eshtë i vogël e kërkesat e mdhaja, mirëpo prioritare duhet të jenë disa projekte, shemëbull fshati Paldenicë i ka diku mbi 200 shtëpi, ne si fshat kemi shumë probleme, por problemi kryesor që e kemi eshtë te nënkalimi gjatë sezonit të dimrit, qysh kur eshtë ndërtu autostrada eshtë projekti që janë shpronësu pronat te Lagjja e Lokve për me dal edhe një rrugë direkt te ish kazerma e TMK-së. Te nënkalimi sidomos në seoznës e dimrit dhe reshjeve, ka pas edhe që vet vajzen ma kanë shkel. Do të thotë eshtë projekt që ka qenë edhe ma herët, nuk eshtë që kushton shumë si projekt. Tjetër propozim, ne e kemi një zonë turistike qe i thuhet Kroni i Stanës qe i lidh shumë fshatra, ku eshtë e shtrume me asfallt prej Dërmjakit, Neçavcit e vjen deri te Kroni, e atz eshtë edhe një rrugë nuk di saktë me metra, por besoj eshtë diku deri 2.5 – 3 km që e lidh fshatin Vërtomicë, i cili nuk eshtë i banueshëm por që njerëzit dalin si turizëm, edhe me u lidh kjo rrugaq që bjen te Kroni i Paldenicës ose që lidhet me Ramukt, te rruga që eshtë shtru te Fujzat

që i thuhet. Poashtu me rënien e breshërit që përvëç dëmeve që na i ka shkaktu në mjete dhe shtëpi, i ka dëmtu edhe rrugët, siç është rruga prej te shkolla apo rruga që është te mahalla e boshnjakëve që quhet.

**Lindita Ballazhi:** Ne i kemi marrë propozimet tuaja, poshtu kemi edhe edhe mundësi tjera për t'i diskutu, por që gjithsesi do ta kemi edhe Komitetitn për Politikë dhe Financa për ta diskutu. Ne me materialin e Kuvendit do t'ua përcjellim listën e krejt propozimeve dhe e fundit do të jetë e juaja si asmbale se cilat projekte do t'i votoni në KAB.

**Ahmet Krasniqi – banor i fshatit Paldenicë dhe drejtor në SHFMU “Kështjella e Diturisë” në Paldenicë:** Unë si banor i fshatit Paldenicë nuk jam i kënaqur me disa projekte që kanë kalu në komunë, shembull kalon me votat kuvendare për një villë me shku rruhu në Seçishtë, e të tjera, dhe problemet kryesore që janë i lëmë anash. Në nuk i kuptoj edhe këta nga asambleja që janë nga fshati Paldenicë që i kalojnë nga 5 projekte të Seçishtës e asnjë projekt të Paldenicës. Si problem që une e shtroj qe disa vite e që është problem i madh është futja e dy përronjëve në koritë, i cili është 8 metra i gjanë e shkakton problem edhe nëpër shtëpi. Mos t'presim me prish ndonjë shtëpi ose me e marr ndonjë fëmije, por të marrim masa sa është ma herët. Ndërsa si drejtor i shkollës, shpreh shqetësim se nxënësit janë të rrezikum e duhet urgjent një trotuar prej te shkolla e deri poshtë te shitorja.

**Lindita Ballazhi:** Projektet që i propozuat i kemi në listën e projekteve kapitale, mirëpo diçka projekt të hartum nuk kemi.

**Vahid Qupi – banor i fshatit Paldenicë:** Çështjet e ujërave atmosferike janë brengë e vazhdueshme e jona. Krejt kjo pjesa që kalon nëpër rrugën te mahalla e boshnjakëve , epër me pas se sa dëm ka bo, është edhe një projekt infrastrukturor që ë ka bo komuna për asfaltin që shkon poshtë se sa e ka prish asfaltin. Krejt ai dëm që shkaktohet, kalon nëpër këtë rrugë dhe përfundon në oborret tona dhe sa herë bjen shi përvëç ujërave atmosferikë, dalin edhe ujërat fekalë. Unë kam bisedu me drejtorin e shërbimeve publike, i cili më ka adresu te drejtori i Urbanizmit, kam bisedu edhe me të dhe ai më tha që sivjet nuk kemi mundësi për shkak se pjesën ma të madhe të buxhetit e merrkan këto të kontratae kolektive, mirëpo për vitin e ardhshëm me premtoi që si projekt mundet me u realizu. Përveç tjerash, për me u fut në koritë me u bashkangjitë më “Përruin e thatë” që quhet. Po e ripërsëris, ai ujë atmosferik kur bjen shi pëerzihet me ujërat fekal , dhe derdhen nëpë oborret tona, ne kemi të mbjellura dhe ajo e mbjellur mund të jetë ushqim i kontaminum. Kjo pjesë kosnideroj se është më prioritet për fshatin tonë.

**Lindita Ballazhi:** Ne patjetër do t'i marrim sugjerimet tuaja dhe do t'i paraqesim në raport bashkë me statusin e tyre.

**Lindita Ballazhi:** Ne kemi mbajtë procesverbal të këtij debati dhe të gjitha propozime tuaja do të shqyrtohen sërisht. Nëse dikush ka ndonjë pyetje tjetër apo propozim, mundeni edhe të më drejtorheni në emailin tim [Lindita.ballazhi@rks-gov.net](mailto:Lindita.ballazhi@rks-gov.net) apo edhe kërkosat tuaja t'i dërgoni fizikisht tek Qendra për Shërbim me Qytetarë, e më pas ne do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkosat, sugjerimet, rekomandimet dhe propozimet tuaja, si ato gjatë këtij debati, ashtu edhe ato përmes

emailit dhe përmes dërgimit te QSHQ. Nëse nuk ka tjetër diskutim apo propozim, e konsideroj të mbyllur debatin publik.

Debati publik përfundoi në orën 12:15.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA - MUNICIPALITY  
HANI I ELEZIT



LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR PËR KORNIZËN  
AFATMESME BUXHETORE 2025-2027

Lokacioni: SHFMU "Kështjella e Diturisë"

Data: 13.06.2024

Ora: 13:30

NR	EMRI DHE MBIEMRI	NUMRI KONTAKTUES	NËNSHKRIMI
1	ALSIM DERNJANI	[REDACTED]	[Signature]
2	Abdurrahman Bushati	[REDACTED]	[Signature]
3	VAHIT QUPI	[REDACTED]	[Signature]
4	Amir Dernjani	[REDACTED]	[Signature]
5	Tobin Qupi	[REDACTED]	[Signature]
6	MINIR DERNJANI	[REDACTED]	[Signature]
7	Ahmet Krasnogj	[REDACTED]	[Signature]
8	Kimele Ruka	[REDACTED]	[Signature]
9	ZAIM TELA	[REDACTED]	[Signature]
10	MALINDA KALOŠTI	[REDACTED]	[Signature]
11			
12			
13			